



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Reclassified as Public pursuant to CS003/F00004 of 2 February 2026

Numri i lëndës: KSC-SC-2025-05/CS003

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 shkurt 2026

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Vendim mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin
e Dënimit të z. Haxhi Shala
me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte***

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Personit të dënuar
Haxhi Shala

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke mbajtur parasysh nenin 51(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullat 196 dhe 197 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe nenet 3, 6 dhe 9 deri 11 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit ("Udhëzuesi i Punës"), pas këshillimeve me gjykatësit e Trupit Gjykues që dha dënimin, lëshon këtë vendim mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të z. Haxhi Shala ("z. Shala").

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 dhjetor 2025, Kryetarja lëshoi Vendimin mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte* ("Vendimi i 11 Dhjetorit 2025"), në të cilin ajo, ndër të tjera, konstatoi se modifikimi i dënimit të z. Shala nuk ishte i përshtatshëm në atë kohë, sepse ai nuk shprehu pendim dhe nuk u distancua prej veprave penale për të cilat u shpall fajtor.¹ Rrjedhimisht, Kryetarja urdhëroi Administratoren të dorëzonte një raport të mëtejshëm më 11 shkurt 2026, ku të pasqyronte informacionin sipas rregullës 196(3) të Rregullores, përfshirë ndonjë distancim të qartë dhe njëmendtë të z. Shala prej veprës penale për të cilën u shpall fajtor.²

2. Në Vendimin e 11 Dhjetorit 2025, Kryetarja shqyrtoi një numër faktorësh që mund të peshonin në favor të modifikimit të dënimit të z. Shala për të mundësuar lirimin me kushte të caktuara.³ Në veçanti, Kryetarja vuri në dukje se: (i) z. Shala ka treguar disa shenja rehabilitimi; (ii) marrëdhëniet pozitive familjare, mjedisi i qëndrueshëm i jetesës dhe rrjeti i gjerë shoqëror tregojnë se ai ka perspektivë të arsyeshme rishoqërizimi dhe riintegrimi të suksesshëm në Kosovë në qoftë se lirohet;

¹ F00003, Vendim mbi Uljen, Modifikim ose Ndryshimin e Dënimit të z. Haxhi Shala me Shtojcat Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 11 dhjetor 2025 ("Vendimi i 11 Dhjetorit 2025"), para. 66. Historiku procedural është parashtruar në hollësi në Vendimin e 11 Dhjetorit 2025, para. 1-10.

² Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 68, 70.

³ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 67.

(iii) gjasat që lirimi i tij të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë janë shumë të vogla; dhe (iv) V01/10 nuk ka shprehur kundërshtim ndaj lirit të mundshëm të z. Shala.⁴ Kryetarja vë në dukje më tej se z. Shala ka bërë të ditur se, ndonëse i gjykon të panevojshme kushtet e lirit, ai do të pranojë çfarëdo kushtesh që Kryetarja i gjykon të përshtatshme.⁵

3. Më 23 janar 2026, Kryetarja mori një letër nga z. Shala, që mban datën 20 janar 2026 ("letra"), ku ai shprehu keqardhjen e tij ndaj kujtudo që mund të kishte pësuar dëm nga veprimet e tij.⁶

4. Më 27 janar 2026, dhe duke mbajtur parasysh letrën e z. Shala, Kryetarja ftoi Administratoren të dorëzonte raportin e saj deri më 30 janar 2026,⁷ i cili u dorëzua po të ditë ("Raporti i Mëtejshëm").⁸

II. PARASHTRIMET

5. Në letrën e tij, z. Shala thotë se pas marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kryerjes së dy të tretave të dënimit, ai kishte pritur që Kryetarja t'ia ulte dënimin. Ai thotë më tej se nuk ishte informuar mjaftueshëm që, krahas pranimin të fajësisë, nga ai kërkohej të shprehte keqardhje për sjelljen e tij dhe kishte menduar se këtë do të mund ta bënte në një seancë gojore.⁹ Z. Shala deklaroi se "me këtë rast, dhe sa herë do të jetë e nevojshme, unë shpreh keqardhjen time për cilindo që mund të ketë pësuar dëme nga veprimet e mija duke përfshirë dhe cilëndo viktimë në rastin tim."¹⁰

6. Në Raportin e Mëtejshëm, Administratorja parashtron se që nga raporti i mëparshëm, zoti Shala nuk ka marrë asnjë vërejtje apo masë disiplinore dhe se nuk ka

⁴ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 67.

⁵ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 67.

⁶ Shtojca 1 (konfidenciale).

⁷ Shtojca 2 (konfidenciale).

⁸ Shtojca 3, Informacioni i Mëtejshëm i Kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit në lidhje me z. Haxhi Shala, 30 janar 2026 ("Raporti i Mëtejshëm") (konfidencial dhe *ex parte*).

⁹ Shtojca 1 (konfidenciale).

¹⁰ Shtojca 1 (konfidenciale).

pasur ndryshim të rrethanave që nga raporti i mëparshëm.¹¹ Gjithashtu, ajo e informoi Kryetaren se pasi i mori dokumentet në Raportin e Mëtejshëm të saj, z. Shala nuk pati ndonjë koment në lidhje me ato dokumente.¹²

7. Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtron se qëndrimi i saj që nga parashtrimet e fundit mbetet i pandryshuar dhe se dënimi që iu dha z. Shala nuk duhet të ulet, duke vënë në dukje se nuk ka pasur ndonjë bashkëpunim të konsiderueshëm të z. Shala me ZPS-në.¹³

III. ANALIZË

8. Kryetarja kujton konstatimin e saj të mëparshëm se ulja e dënimit të z. Shala nuk është e përshtatshme,¹⁴ por se ka një numër faktorësh peshojnë në favor të modifikimit të mundshëm të dënimit, ndonëse me kushte.¹⁵ Ajo ishte e mendimit se ky modifikim ishte i papërshtatshëm në atë kohë, duke marrë parasysh se z. Shala zgjodhi të mos shprehte pendim apo të tregonte distancim të njëmendtë prej veprave penale për të cilat u shpall fajtor.¹⁶

9. Kryetarja mban parasysh se z. Shala jo gjithmonë ishte i gatshëm të distancohej prej veprave penale për të cilat u shpall fajtor, me gjithë mundësitë e shumta që iu dhanë për ta shprehur këtë, qoftë gojarisht në seancën për marrëveshjen e pranimit të fajësisë, apo me shkrim.¹⁷ Megjithatë Kryetarja vë në dukje se shprehjen e keqardhjes nga z. Shala në letrën e tij të 20 janarit 2026. Kryetarja vëren se shprehja e keqardhjes nga z. Shala e mbështetej në shpjegime për keqkuptim nga ana e tij, ose në faktin se nuk i ishte shpjeguar mjaftueshëm që krahas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duhej të kishte shprehur edhe keqardhje për sjelljen e tij. Kryetarja vë në dukje

¹¹ Raporti i Mëtejshëm, Shtojca 3 (konfidenciale dhe *ex parte*).

¹² Shtojca 5 (konfidenciale).

¹³ Shtojca 4 (konfidenciale).

¹⁴ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 64.

¹⁵ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 67.

¹⁶ Vendimi i 11 dhjetorit 2025, para. 68.

¹⁷ Vendimi i 11 Dhjetorit 2025, para. 68.

gjithashtu se z. Shala kishte “pritur” të lirohej pas marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kryerjes së dy të tretave të dënimit me tre vjet burgim.¹⁸

10. Sikurse është thënë disa herë, Kryetarja thekson se personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara plotësojnë kriterin për *shqyrtim* për ulje të dënimit vetëm pasi të kenë vuajtur dy të tretat e dënimit dhe se plotësimi i kriterit nënkupton marrje në *shqyrtim* dhe jo të drejtë të *vetvetishme* për ulje të dënimit.¹⁹

11. Sa i përket shprehjes së keqardhjes nga z. Shala, Kryetarja vë në dukje se z. Shala shkroi letrën me nismën e vet dhe pa ndihmën e një përfaqësuesi ligjor, pas një periudhe reflektimi në vijim të Vendimit të 11 Dhjetorit 2025. Ndonëse Kryetarja e kupton se keqardhja e shprehur prej tij mund të jetë motivuar nga dëshira për t’u liruar dhe për t’u bashkuar me familjen, ajo sidoqoftë mendon se letra tregon distancim të njëmendtë prej veprave penale për të cilat u shpall fajtor.

12. Kryetarja kujton se veprat penale për të cilat u shpall fajtor z. Shala janë të rënda dhe, ndonëse ai ka treguar shenja distancimi prej veprave penale si dhe shenja rehabilitimi, është e rëndësishme të sigurohet që, duke iu përmbajtur kushteve të përcaktuara në paragrafin 13 më poshtë, z. Shala të vazhdojë në rrugën drejt rehabilitimit të plotë dhe distancimit prej sjelljes për të cilën u shpall fajtor.

13. Pasi ka shqyrtuar tërësinë e informacionit që i është paraqitur, Kryetarja është e mendimit se dënimi z. Shala mund të modifikohet dhe urdhëron lirimin e tij me kushtet në vijim:²⁰

- a) të garantojë se do të banojë tërë kohën në adresën e shtëpisë të dhënë në Parashtrimet e Shalës;²¹

¹⁸ Shtojca 1 (konfidenciale).

¹⁹ Shih Vendimin e 11 Dhjetorit 2025, para. 11.

²⁰ Shih nenin 51(2) të Ligjit, së bashku me nenet 3(1) dhe 10 të Udhëzuesit të Punës.

²¹ KSC-SC-2025-05/CS003, F00002, Parashtrim i Haxhi Shalës në lidhje me Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit (“Parashtrimet e z. Shala”), 1 dhjetor 2025 (konfidencial).

- b) të informojë Administratoren dhe stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja për çdo ndërrim të vendbanimit të përhershëm, në varësi të miratimit nga Kryetarja;
 - c) të paraqitet çdo javë në stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja;
 - d) Administratores t'i dorëzohen pasaporta ose dokumente udhëtimi aktuale dhe të ardhshme të z. Shala;
 - e) të qëndrojnë në Kosovë dhe të informojë Administratoren në rast se dëshiron të udhëtojë jashtë Kosovës dhe kërkesa për leje për udhëtim të miratohet nga Kryetarja;
 - f) të mos kontaktojë apo komunikojë me dëshmitarë ose viktime (të mundshme) para Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së;
 - g) të mos japë deklarata publike, drejtpërdrejt ose tërthorazi, lidhur me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në;
 - h) të kërkojë leje dhe miratim nga Administratorja për intervista ose çfarëdo kontakti tjetër me mediat, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për të Paraburgosurit, posaçërisht në lidhje me komunikimet me mediat;
 - i) të përmbushë vendimet ose urdhrat e Dhomave të Specializuara; dhe
 - j) të mos bëjë komente negative, të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose shtrënguese ndaj ose rreth dëshmitarëve (të mundshëm) ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara, zyrtarëve të Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së.
14. Në përputhje me rregullën 196(4) të Rregullores dhe nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës, kushtet e mësipërme për lirim të z. Shala mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit prej tre vjetësh, domethënë deri më 11 dhjetor 2026.²²

²² Shih nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës.

15. Kryetarja thekson gjithashtu se mospërbushja prej z. Shala e kushteve të përcaktuara në paragrafin 13 do të rezultojë në anulimin ose ndryshimin e vendimit aktual në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës.²³

16. Për arsye të sigurisë operative dhe transferimit të sigurt, Kryetarja gjykon që z. Shala të njoftohet për këtë vetëm pas fillimit të transferimit të tij më 11 shkurt 2026, ose rreth kësaj date.

17. Së fundi, duke pasur parasysh se dënimi i z. Shala u modifikua, çdo rishikim për ndryshimin e dënimit të tij është i tejkaluar.

IV. VENDIM

18. Bazuar në sa më lart, Kryetarja:

VENDOS të modifikojë dënimin z. Shala duke e liruar atë me kushtet e përcaktuara në paragrafin 13 më lart;

URDHËRON z. Shala të përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 13 më lart;

URDHËRON Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme që z. Shala të informohet si duhet për kushtet e përcaktuara në paragrafin 13 më lart;

VENDOS që, në varësi të organizimit të transferimit nga Administratorja, z. Shala të lirohet më 11 shkurt 2026, ose rreth kësaj date, në vendbanimin e tij të përhershëm, në adresën e shtëpisë që është dhënë në Parashtrimet e z. Shala;

URDHËRON Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar transferimin e z. Shala në adresën e shtëpisë së tij që është dhënë

²³ Shih nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës.

në Parashtrimet e Shalës dhe ta njoftojë atë për transferimin pak përpara fillimit të tij;

URDHËRON policinë e Kosovës ose çdo autoritet tjetër në Kosovë që, në përputhje me nenin 53 (1) të Ligjit, të bashkëpunojë me Administratoren për zbatimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 13 më lart dhe t'i dorëzojë Administratores raport mujor lidhur me përmbushjen prej z. Shala të kushteve të përcaktuara në paragrafin 13 më lart;

URDHËRON Administratoren t'i raportojë Kryetares çdo dy muaj lidhur me përmbushjen prej z. Shala të kushteve të përcaktuara në paragrafin 13 më lart, deri në përfundimin e dënimit të tij më 11 dhjetor 2026, ose më herët në rast të shkeljes së kushteve;

URDHËRON Njësinë për Administrimin e Gjykatës që ta riklasifikojë këtë vendim si publik pas konfirmimit të Administratores për mbërritjen e z. Shala në vendin e caktuar të lirimit; dhe

URDHËRON Zyrën Administrative që t'ia dorëzojë këtë vendim z. Shala dhe ZPS-së vetëm pas konfirmimit të mbërritjes së z. Shala në Kosovë.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 2 shkurt 2026
Në Hagë,
Holandë